



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1371\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2155\_03\_21** i dt.31.03.2021;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **14.05.2021**;

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin A.M nga Komuna e Besianës, me shifër të konsumatorit DPR -103737, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2155\_03\_21, i datës 31.03.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 31.03.2021 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2255\_03\_21 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit A.M, nga Komuna e Besianës dhe e ka obliguar të Licencuarin KESCO që ta anulojë faturën nr.07180DPR-103737 të dt.26.07.2018 dhe për këtë periudhë ta faturojë me shpenzimin prej TL=202 kWh dhe TU=107 kWh, lidhur me kontestimin të faturës për periudhën 07/2018 për shkak të dyshimit të leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsorit elektrik nr.64671867.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Konsumatori është ankuar për faturën e lartë të muajin 07/2018 pasi që faza T3 ka kontakt me metal si dhe pasojë ai është dëmtuar me faturim të lartë.
- Duke e pasur parasysh faktin se kontakti me metal ka qenë pas pikës matëse (njehsorit), përgjegjësia mbi këtë rast bie mbi konsumatorin dhe ndërmarrja e energjisë nuk është përgjegjëse për defektet eventuale pas pikës matëse.
- Përderisa ka ndodhur shpenzimi i energjisë elektrike, ai shpenzim është regjistruar në njehsor dhe nuk ka pasur gabim në matje, andaj edhe konsumatori është përgjegjës për shpenzimin e tij;



- Për më tepër, i njëjti konsumator është evidentuar që me qëllim të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike ka kyçur kablo ilegale, duke anashkaluar njehsorin dhe përkatësisht energjia e shpenzuar përmes kësaj kabllorje nuk është regjistruar.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2155\_03\_21 i datës 31.03.2021 për konsumatorin A.M.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që kontakti me metal ka qenë pas pikës matëse dhe përgjegjësia bie mbi konsumatorin, Bordi e vlerëson si jo relevant për faktin se, duke u bazuar në procesverbalin e inspektimit të dt. 21.09.2018 dhe nga fotografitë e pikës matëse, ka konstatuar se, përveç evidentimit mbi zhveshjen e kabllit të bërë nga KEDS-i, të njëjtit nuk kanë evidentuar se çfarë masa janë ndërmarrë, në mënyrë që të evitohet problemi teknik i humbjes së energjisë. Po ashtu, në foton e ofruar nga KEDS-i, vërehet se njëra dalje e njehsorit elektrik është e zhveshur. Bordi i ZRRE-së thekson se, duke u bazuar në pikën 3.5 – Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve matëse, të Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike të OSSh-së, si në vijim: *“3.5.1. Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemeve matëse përfshinë: instalimin fillestar të bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt – përfshirë testimet sistematike dhe certifikimi, ndërrimin e njësive të veçanta dhe njehsorëve, 12 kontrollimin e TMRR, TMT dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminimin, shtrirjen e mirëfilltë të kabllorëve, mbrojtjen, lexime të rregullta dhe periodike të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga njehsori, mirëmbajtjen e Qendrës Grumbulluese të të Dhënave si dhe vëmendjen për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësit e OSSh-së -së të përcaktuara në Ligjin Për Energjinë Elektrike në fuqi. 3.5.2. Mirëmbajtja e njehsorëve është përgjegjësi e OSSh-së”*, mund të konstatojmë se, ka qenë obligim ligjor i KEDS-it që në momentin që është evidentuar një problem teknik, i njëjti është dashur që të sanohet dhe të sqarohen saktë se cilat veprime janë ndërmarrë, dhe një gjë e tillë tek konsumatori në fjalë nuk ka ndodhur.

Sa i përket pretendimit tjetër që konsumatori ka bërë kyçje ilegale dhe ka krijuar shpenzim të paautorizuar të energjisë, Bordi i ZRRE-së thekson se ky argument nuk është relevant në rastin konkret, pasi që **shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike është vepër penale** sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, respektivisht në kapitullin e XXVI – Vjedhja e Shërbimeve, neni 314, një veprim i tillë është i inkriminuar si vepër penale. Rrjedhimisht, ZRRE nuk ka kompetencë në trajtimin e këtyre rasteve, pasi që për vepra penale, kompetente janë institucionet tjera të sistemit të drejtësisë.

Në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë të profilit të konsumatorit, Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike për periudhën kontestuese dhe ka konstatuar se faturimi i shpenzimit për një muaj të vetëm **prej 2,172 kWh** nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, e që kjo vërtetohet me shpenzimet energjisë elektrike të regjistruara për periudha të njëjta kohore të mëhershme, si dhe të mëvonshme ku: periudha 07/2016 është 280 kWh/muaj, periudha 07/2017 është 348 kWh/muaj, periudha 07/2018 është 2,172 kWh/muaj, periudha 07/2019 është 309 kWh/muaj dhe periudha



07/2020 është 313 kWh/muaj. Gjithashtu nga analizat e bëra shpenzimit të energjisë elektrike edhe të periudhave tjera shihet se konsumatori nuk ka shpenzim të energjisë elektrike të faturuar si ajo e periudhës 07/2018, dhe kjo vërtetohet përmes rrjedhës së energjisë elektrike aktive. Po ashtu, Bordi ka analizuar edhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore.

Andaj, mbi këtë bazë, Bordi thekson se, faturimi i konsumatori për periudhën korrik 2018 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit dhe si rrjedhojë fatura 07180DPR-103737 duhet të anulohet dhe se për këtë periudhë konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e periudhës 07/2019 prej TL=202 kWh dhe TU=107 kWh.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit A.M. dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar